



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Data 15 .05.2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale ndërtimi për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2024”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

441100000-4 Materiale ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

5 683 000 (pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Çorovodë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 8;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ky kriter është vendosur që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 ” Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm të pikës 2.2.2 është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit).

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajmë në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjën “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknike:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që mallrat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë *Leje mjedisore kodi III.1.B (Leje e vendosur jo më larg se 50 km nga Bashkia Skrapar)*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik si dhe ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar , kjo kërkesë tregon se operatori ekonomik duhet të vërtetojë se aktiviteti i tij i prodhimit të inerteve është në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore mjedisore në fuqi. Kërkesa e lejës mjedisore jo më largë se 50 km nga Bashkia Skrapar synon të minimizojë distancën dhe kostot e transportit të materialeve ndërtimore.

Pra, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë realizimin me sukses të kontratës si dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor duke qënë se kjo Ndërmarrje nuk ka një vend magazinimi.

2.3.3 Deklaratë nga Operatori Ekonomik që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në çdo kohë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë realizimin me sukses të kontratës si dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalent e vleshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombetare Akreditues ,të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

Kërkesa për certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente të akredituar nga një organ i njohur ndërkombëtar, synon të garantojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë sistemet e duhura të menaxhimit të cilësisë. Kjo certifikatë tregon se operatorët ekonomikë kanë kapacitetet e nevojshme për të ofruar produkte me cilësi të lartë, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Argumentimit thekson rëndësinë e certifikimit të akredituar për të siguruar cilësinë, besueshmërinë dhe standardizimin e materialeve ndërtimore, të cilat janë thelbësore për realizimin me sukses të kontratës. Kjo kërkesë për certifikatë të akredituar synon të garantojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë aftësitë e duhura për të përmbushur me sukses kërkesat e kontratës. Në thelb, argumentimi teknik mbështet vendosjen e këtij kriteri si një mënyrë për të siguruar cilësinë dhe standardet e larta të produkteve që do të ofrohen në kuadër të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet si më mëposhtme:

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti me peshëmbajtje mbi 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

Për të dëshmuar këtë, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nese janë në pronësi, duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit teknik, policen e sigurimit vjetor të vlefshme gjatë zbatimit te kontratës)
- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik, nese janë me qera, duhet të paraqiten dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, kontrata noteriale e qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, regjistrimi i mjetit (leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, policia e sigurimit vjetor të vlefshme gjatë zbatimit të kontratës)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e makinerisë së mësipërme.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Disponimi i këtij mjete tregon se Operatorët Ekonomik kanë aftësitë e duhura për të kryer transportin e materialeve të Ndërtimit.

Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për të siguruar realizimin e kontratës në mënyrë efikase dhe të sigurt duke marrë parasysh volumet e mallrave që duhet të transportohen.

Mjeti i transportit me kapacitet mbi 10 ton është një element i rëndësishëm për realizimin e kontratës. Ky lloj mjeti është i nevojshëm për të transportuar materialet e ndërtimit në sasinë dhe kohën e duhur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT